



6 JANAR 2015

## ECMI KOSOVA DËNON BLOKADËN E DHUNSHME TË HYRJES SË KISHËS ORTODOKSE SERBE NË GJAKOVË DHE I BËN THIRRJE AUTORITETEVE NË KOSOVË QË TË SIGUROJNË QASJE TË LIRË DHE TË PAPENGUAR NË OBJEKTET E KULTIT

Më 6 janar, aktivistë të Vetëvendosjes së bashku me OJQ-në "Thirrjet e Nënave" organizuar një protestë para ambienteve të Kishës Ortodokse Serbe në Gjakovë, në mënyrë që të parandalohen pelegrinët fetarë që të hyjnë në kishë. Protesta ishte kryesisht e qetë dhe paqësore. Policia e Kosovës intervenoi dhe shpërndau protestuesit, duke arrestuar dy persona në proces.

Pelegrinët - shumë prej të cilëve janë me origjinë nga Gjakova - udhëtojnë nga Serbia në Gjakovë çdo vit në këtë kohë, në mënyrë që të marrin pjesë në meshën për Krishtlindjet serbe, një feste fetare që festohet më 7 janar. Sipas raporteve të medieve në Kosovë, një aktivist i Vetëvendosjes hodhi një cope akulli në drejtim të pelegrinëve, duke thyer dritaren e përparme të autobusit me të cilin ata kishin udhëtuar. Sipas deklaratës së zëdhënësit rajonal të Policisë së Kosovës të dhënë për *Gazeta Jeta në Kosovë*, Policia e Kosovës ka arrestuar individin që kishte hedhur akull dhe menjëherë ka siguruar zonën. Zëdhënësi i Policisë gjithashtu vuri në dukje se, sipas vetë pelegrinëve, ata kishin vendosur të ktheheshin meqë rruga kishte shumë akull dhe autobusi që i bartte ata nuk ishte në gjendje të hynte në oborr të kishës.<sup>1</sup> Megjithatë, mediat në Serbi raportojnë se ngjarja kishte ndodhur ndryshe, duke cituar fjalët e kryesuesit të Shoqatës së Qytetarëve të Zhvendosur, Xhokica Stanojeviq, i cili kishte deklaruar për *B92* se ata ishin detyruar ta anulonin udhëtimin meqë aty kishte protesta dhe njerëz që hidhnin gurë në drejtim të tyre, duke lënduar lehtë shoferin e autobusit.<sup>2</sup>

Vetëvendosje dhe "Thirrjet e Nënave", kanë thënë se kanë dalë për të protestuar ardhjen e "kriminelëve të dyshuar të luftës që ata konsiderojnë të jenë fajtor për kryerjen e krimeve"

<sup>1</sup> Për më shumë, shihni këtu <http://live.kallxo.com/sq/MTL/Pelegrinet-Perseri-Kthehen-Pa-Hyre-ne-Kishe-te-Gjakoves-3940>

<sup>2</sup> Për më shumë, shihni këtu [http://www.b92.net/info/vesti/index.php?yyyy=2015&mm=01&dd=06&nav\\_category=640&nav\\_id=944135](http://www.b92.net/info/vesti/index.php?yyyy=2015&mm=01&dd=06&nav_category=640&nav_id=944135)

në Gjakovë, dhe gjithashtu ardhjen e Xhokica Stanojeviq-it, ish kryetar i komunës së Gjakovës gjatë regjimit represiv të Slobodan Milosheviq-it . Komuna e Gjakovës ishte një nga zonat më të goditura gjatë konfliktit të viteve 1998-1999, me shumë viktime civile dhe një numër të madh të njerëzve të cilët ende vazhdojnë të jenë të zhdukur dhe/apo të pagjetur.

ECMI Kosova rithekson nevojën për të garantuar sigurinë e të gjithë qytetarëve, pa marrë parasysh përkatësinë e tyre etnike në Kosovë, veçanërisht me rastin e ngjarjeve të cilat kanë natyrë apo karakter emocional për komunitetet e Kosovës. Siç është e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, është detyrë e autoriteteve publike për të siguruar që të gjithë qytetarët dhe pjesëtarët e komuniteteve të gëzojnë lirinë e lëvizjes dhe qasje të papenguar në vendet e ushtrimit të ritualeve fetare në të gjithë territorin e Kosovës. ECMI Kosova rikujton se ndërsa protestimi paqësor është e drejtë e garantuar, pretendimet për krime të luftës duhet të trajtohen nëpërmjet kanaleve dhe/apo institucioneve të duhura ligjore dhe se bllokimi i dhunshëm i hyrje të vendeve të kultit paraqet një akt të dhunës që pengon bashkëjetesën e qëndrueshme të komuniteteve në Kosovë dhe nuk sjell para drejtësisë përgjegjësit për krime të luftës.

Për të lexuar më shumë mbi zhvillimet politike ju lutem shihni përditësimet dhe analizat tona të fundit politike:

- *Sfidat në procesin e emigrimit në Kosovë: Emigrimi në rritje i romëve, ashkalinjëve, dhe egjiptasëve* - <http://www.ecmikosovo.org/wp-content/uploads/2014/12/Albanian.pdf>
- *Përngjitja e ndarjes: Themelimi i një bordi të përbashkët për qytetin e Mitrovicës*  
[http://www.ecmikosovo.org/wp-content/uploads/2014/06/Policy-Brief\\_Joint-Board-Final-shqip.pdf](http://www.ecmikosovo.org/wp-content/uploads/2014/06/Policy-Brief_Joint-Board-Final-shqip.pdf)
- *Përmbledhje e shkurtër e zhvillimeve politike nga ana e ECMI Kosovës: Komunitet pakicë dëshirojnë të shohin fundin e ngërçit politik* - <http://www.ecmikosovo.org/wp-content/uploads/2014/10/Albanian1.pdf>
- *Incidenti tragjik në Fushë Kosovë që përfshin një fëmijë rom* - <http://www.ecmikosovo.org/wp-content/uploads/2014/12/Albanian4.pdf>
- *Një vështrim i shkurtër mbi situatën e fundit të sigurisë në Kosovë* - <http://www.ecmikosovo.org/wp-content/uploads/2014/11/Albanian.pdf>
- *Zgjedhjet e përgjithshme në Kosovë: Një shikim i çështjeve, sfidave dhe skenës politike në prag të zgjedhjeve të 8 qershorit* - <http://www.ecmikosovo.org/wp-content/uploads/2014/06/Information-Bulletin-Minority-Party-Elections-SQ.pdf>
- *Një Përmbledhje e disa prej ndryshimeve në Projektligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës* - <http://www.ecmikosovo.org/?p=4735> (Anglisht)

# PRESS RELEASE

Për më shumë informata, ju lutem kontaktoni:

ECMI Kosovo

Tel: + 381 (0) 38 224 473

Email: [info@ecmikosovo.org](mailto:info@ecmikosovo.org)

Web: [www.ecmikosovo.org](http://www.ecmikosovo.org)

## Rreth ECMI Kosova

ECMI Kosova është organizata kryesore joqeveritare e përfshirë në çështje minoritare në Kosovë, me qëllim të gjithëmbarshtëm që të zhvillojë institucione gjithëpërfshirëse, përfaqësuese, të ndjeshme ndaj komuniteteve e që përkrahin një Kosovë stabile shumetnike. ECMI Kosova kontribuon për zhvillimin, fuqizimin dhe zbatimin e legjislacionit përkatës, përkrah institucionalizimin e organeve qeveritare që punojnë me komunitetet, dhe shton kapacitetet e aktorëve të shoqërisë civile dhe të qeverisë për t'u përfshirë me njëri-tjetrin në një mënyrë konstruktive dhe të qëndrueshme.